



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 15/42

Datë: 19.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (3) dhe (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projekt Platforma për finalizimin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, për normalizimin e marrëdhënieve në mes dy vendeve.
2. Projekt Platforma nga pika 1 e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim dhe Presidentit të Republikës së Kosovës për informim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

*Ramush Haradinaj*  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë